



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202100545/10

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022

**Lënda:** *Rekomandim për rivlerësimin e kërkesës dhe fillimin e procedurës administrative për transferimin e shtetasit A. S. nga burgu në Kosovë në një burg të Shqipërisë, për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit më afër vendbanimit të familjes*

**MINISTRISË SË DREJTËSISË**

Tiranë

Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur jeni njohur me ankesën e shtetasit G. S., i cili pretendon se po zvarritet procedura për transferimin e djalit të tij A. S. nga Burgu \_\_\_\_\_ në Kosovë në një Institucion të Ekzekutimit të Vendimit Penal të vendit tonë, për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit në Shqipëri, kryesisht për arsye sigurie, pasi në burgun e Kosovës është plagosur nga disa bashkëvuajtës. Ndër të tjera, ankuesi shpjegon se, që nga viti 2018, djali A. S. dhe familjarët, kanë bërë kërkesa në vijimësi në Ministrinë e Drejtësisë për transferimin e tij në një burg të Shqipërisë, por përgjigjet kanë qenë gjithmonë se kërkesa nuk mund të realizohet për arsye të hapësirave të kufizuara në sistemin penitenciar.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Shkresa me Nr.4793/2 Prot., datë 22.05.2018 e Ministrisë së Drejtësisë drejtuar A. S. në Burgun \_\_\_ Kosovë si dhe shkresa me Nr. 18/1 Prot., datë 22.01.2018 e Ministrisë së Drejtësisë drejtuar institucionit tonë.

Lidhur me këtë çështje, me shkresën tonë Nr.K2/GJ1-2 Prot., datë 08.04.2021 jemi interesuar pranë institucionit tuaj nëse kishte patur verifikime pas vitit 2018 lidhur me mundësinë e transferimit të të dënuarit A. S. në një IEVP të Shqipërisë dhe nëse ishte i mundur transferimi i tij gjatë vitit 2021.

Në përgjigjen që kemi marrë me shkresën Nr.1555/1 Prot., datë 19.04.2021 sqarohet se: ka një numër të konsiderueshëm shtetasish shqiptarë të dënuar që presin të transferohen në burgjet e Shqipërisë dhe pranimi i kërkesave të tyre nuk është një çështje thjesht procedurale apo administrative, por është një çështje që lidhet me politikën penitenciare shtetërore, hapësirat e lira në sistemin penitenciar, marrëdhëniet me shtetet e ndryshme si dhe vlerësimin e kostove të shtuara financiare për mbajtjen e çdo të dënuari të burgosur në burgjet tona konform standardeve aktuale europiane. Kërkesa dhe pëlqimi i shtetasit A. S. për transferimin e tij dhe aktet procedurale të nevojshme për njohjen e vendimit penal në Shqipëri, të përcjella me shkresën Ref: MD/DBGJ/660/FG/18 DBJN/2003-123, datë 23.02.2018 të Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës, në cilësinë e autoritetit qendror përgjegjës për kërkesat për transferim, i janë kthyer kësaj Ministrie në kushtet e pamundësisë aktuale të trajtimit të saj. Gjithashtu në këtë përgjigje jemi informuar se kërkesa për transferim nuk mund të vlerësohet në mungesë të akteve të përditësuara dhe informacioneve të nevojshme lidhur me gjendjen e rënduar të të dënuarit në Kosovë.

Në kuadër të bashkëpunimit të frytshëm që kemi me institucionin e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës dhe bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit lidhur ndërmjet institucioneve tona me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese të shtetasve të vendeve tona nga organet respektive të administratës, në vijim të shqyrtimit të këtij rasti, u jemi drejtuar

që brenda kompetencave, të verifikojnë gjendjen në të cilën ndodhet i dënuari A. S. në Burgun \_\_\_\_\_.

Në përgjigjen që na ka kthyer Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në datën 15 Tetor 2021 jemi vënë në dijeni se, përfaqësues të këtij institucioni kanë kryer vizitë në burgun ku mbahej i dënuari A. S. Sipas deklarimeve që ka dhënë vetë i dënuari, ai është dhunuar disa herë fizikisht nga të dënuar të besimit mysliman, për arsye të besimit të tij katolik, dhe ndihet i rrezikuar. Fakti që ky i dënuar është dhunuar disa herë nga bashkëvuajtësit është pranuar edhe nga institucioni i vuajtjes së dënimit. Ky i dënuar ka marrë disa masa disiplinore për shkak të sjelljes së tij. Kërkesa për t'u liruar me kusht dhe për të përfituar leje shpërblyese nuk është pranuar. Aktualisht i dënuari A. S. është transferuar në Qendrën Korrektuese \_\_\_\_\_, ku bazuar në informacionin e sektorit të sigurisë, nuk ndodhen persona me të cilët ka pasur konflikt. Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës është interesuar edhe në Ministrinë e Drejtësisë lidhur me kërkesën e të dënuarit A. S. për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit në Shqipëri. Ministria e Drejtësisë së Kosovës është shprehur se me shkresën e datës 05.10.2016 është njoftuar Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë se kërkesa e të dënuarit A. S. i plotëson kushtet ligjore për transferim duke dërguar gjithashtu dokumentacionin përkatës. Kjo kërkesë nuk është pranuar për mungesë të hapësirave në IEVP-të e vendit tonë duke njoftuar gjithashtu, se po bëheshin përpjekje për krijimin e hapësirave në sistemin shqiptar penitenciar. Kjo kërkesë u është përcjellë sërish autoriteteve shqiptare në datën 23.02.2018 si dhe në vitin 2020 me postë elektronike, por nuk është dhënë përgjigje. Po ashtu në informacionin e dërguar, evidentohet se Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë përgjigje të tilla ka kthyer në disa vite, për të gjitha kërkesat e ngjashme për transferime të dërguara nga institucioni i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, me arsyetimin e mungesës së kapaciteteve.

Në kushtet kur numri i kërkesave të shtetasve shqiptarë për t'u transferuar në burgjet e Shqipërisë është i konsiderueshëm dhe shtetasi A. S. ka paraqitur disa kërkesa për transferim nga viti 2018 e në vijim, ju ridrejtuam me shkresën tonë Nr.K2/Gj1-5 Prot., datë 21.10.2021. Me anë të saj kërkuam informacion lidhur me procedurën që ndiqet për transferimin e të burgosurve shqiptarë, nga një IEVP jashtë vendit në një IEVP në Shqipëri, për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit më afër vendbanimit të familjes apo për arsyë të tjera, duke patur parasysh faktin se gjendja e mbipopullimit është dinamike dhe këmbimi i dokumentacionit ndërmjet institucioneve kërkon kohë. Po ashtu, nëse kërkesa nuk pranohet si në rastin në fjalë, për arsye të mbipopullimit, cila është praktika që ndiqet: kjo kërkesë duhet të përsëritet në vazhdimësi nga i interesuari, apo nga ana e institucionit tuaj kërkohet informacion i përditësuar kur ka vende të lira në sistemin penitenciar dhe si bashkërenditet puna me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në këto raste. Duke patur parasysh numrin jo të vogël të kërkesave për transferim, një pyetje tjetër e shtruar nga ana jonë ishte nëse zbatohet ndonjë kriter lidhur me kërkesat që do të kenë përparësi, si psh. data kur është paraqitur etj., dhe nëse është marrë sërish në shqyrtim kërkesa të dënuarit A. S. për t'u transferuar në një IEVP të Shqipërisë. Në kuadër të hetimit tonë administrativ u interesuam edhe në lidhje me numrin e të burgosurve që janë transferuar me kërkesën e tyre në Shqipëri në pesë vitet e fundit, për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit në vendin tonë.

Në përgjigjen që kemi marrë nga Ministria e Drejtësisë me shkresën Nr.3995/3 Prot., datë 06.12.2021 thuhet se:

*“Nga përgjigjet e transmetuara përkatësisht rezulton se vendimmarrja për pranimin e kërkesës dhe fillimin e procedurës së transferimit të këtij shtetasi nga Ministria e Drejtësisë ka qenë e pamundur në kuadër të kapaciteteve të*

*kufizuara të sistemit penitenciar dhe të numrit tepër të madh të shtetasve shqipëtar të dënuar jashtë Shqipërisë që kërkojnë të transferohen.*

*Aktualisht Ministria e Drejtësisë po rivlerëson me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve situatën aktuale të burgjeve me qëllim zhbllokimin e situatës në përputhje me politikat penitenciare.*

*Në lidhje me procedurën e transferimit të personave të dënuar, ju bëjmë me dije se në rastet kur për kërkesat është kthyer përgjigje negative, është subjekti ai që riparaqet kërkesën për transferim në burgun ku vuan dënimin dhe Ministria e Drejtësisë e shtetit dënues që riparaqet së pari kërkesën për informacion nëse kushtet e situatës penitenciare kanë ndryshuar si dhe kërkesën për dokumentacionin e nevojshëm për fillimin e procedurës së transferimit.*

*Pa dyshim që në pranimin e kërkesave për transferim do të vlerësohet prioriteti i kriterëve të përcaktuara nga Konventat Europiane për transferimin e personave të dënuar dhe Marrëveshjet Dypalëshe të tilla si: kushtet sociale, shëndetësore, familjare, fetare etj., që janë prioritare në përzgjedhjet e subjekteve, koha e paraqitjes së kërkesës nga i dënuari dhe masat e dënimit.*

*Gjithashtu, referuar komunikimeve të bëra mbi këtë shtetas ju informojmë se procedura e transferimit duhet të fillojë me kërkesën dhe pëlqimin e shprehur të shtetasit të dënuar që kërkohet të transferohet dhe të përcillet nëpërmjet autoriteteve të përcaktuara në Konventa dhe Marrëveshje Dypalëshe dhe në asnjë rast nuk mund të fillojë me kërkesat e familjarëve, me kërkesa për informacion të insitucioneve, vendime urdhëruese të Gjykatës Administrative apo kërkesa të përcjella nga përfaqësuesit diplomatikë”.*

Referuar kuadrit ligjor, për të përmbushur synimin e dënimit me burgim, rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurit në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike, në Ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 39, pika 5, është përcaktuar se të burgosurit, si rregull, caktohen në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre. Këtij qëllimi i shërben edhe Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar”, ratifikuar me Ligjin Nr.8499, datë 10.06.1999.

Për sa i përket mospranimin të kërkesës të shtetasit A. S. për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit në Shqipëri, Ministria e Drejtësisë na ka dhënë vetëm informacion të përgjithshëm se arsyeja është mbipopullimi i I EVP-ve në vend, por nuk ka vënë në dispozicion ndonjë shkresë ku të jetë marrë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve lidhur me kapacitetet dhe popullimin e I EVP \_\_\_\_\_, që ndodhet më afër vendbanimit të familjes së të dënuarit, apo të ndonjë I EVP-je tjetër. Referuar informacionit të dhënë nga Avokati i Popullit të Kosovës, Ministria e Drejtësisë së Kosovës ka njoftuar Ministrinë e Drejtësisë së Shqipërisë që në vitin 2016, se kërkesa e të dënuarit A. S. i plotëson kushtet ligjore për transferim duke dërguar gjithashtu dokumentacionin përkatës. Njoftimi i fundit është bërë me postë elektronike në vitin 2020, por nga pala jonë nuk është dhënë përgjigje.

Çmujmë se Ministria e Drejtësisë e ka të pamundur të pranojë të gjitha kërkesat për transferim të shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë Shqipërisë, për arsye se pranimi dhe administrimi i këtyre kërkesave dhe zbatimi i Konventës për Transferimin e Personave të Dënuar apo i Marrëveshjeve Dypalëshe është një çështje jo vetëm administrative por që lidhet edhe me faktorë të tjerë të përmendur më lart, sikurse janë kapacitetet e kufizuara të sistemit tonë penitenciar etj.

Por, nisur nga ky rast, vlerësojmë se duhet të ketë një vëmendje dhe angazhim të shtuar të autoriteteve shqiptare për krijimin e hapësirave të nevojshme akomoduese për të mundësuar transferimin e shtetasve shqiptarë për të vuajtur dënimin në IEVP-të e vendit tonë. Ky proces paraqet rëndësi të veçantë, sidomos në rastet e kërkesave të të burgosurve apo familjarëve të tyre që referojnë arsye specifike si rrezik për jetën, arsye shëndetësore, arsye familjare apo vështirësi ekonomike etj.

Në këto kushte, kur shtetasi A. S. ka dhënë disa herë pëlqimin për t'u transferuar në një burg të Shqipërisë, dhe dokumentacioni përkatës është përcjellë nga Ministria e Drejtësisë së Kosovës, është e nevojshme që të verifikohet dhe vlerësohet mundësia e transferimit të tij në IEVP \_\_\_\_ apo në ndonjë IEVP tjetër në vendin tonë, sa më afër vendbanimit të familjes.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

### **REKOMANDOJMË:**

Marrjen e masave të nevojshme për rivlerësimin në kushtet aktuale dhe fillimin e procedurës administrative për transferimin e shtetasit A. S. nga burgu në Kosovë në një Institucion të Ekzekutimit të Vendimeve Penale të Shqipërisë, për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit më afër vendbanimit të familjes.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**